



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 159, Datë 05.06.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“ASSA ENERGY SOLUTIONS” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1641/1 prot., datë 03.06.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1641 prot., datë 20.05.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 MWac.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar, rezulton se:

**Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren**

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencim në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (c, d dhe e).

### **Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera**

Shoqëria “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në datën 25.11.2024 “Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një Impianti Fotovoltaik me një kapacitet të instaluar prej 10 MWac dhe Kapacitet të Mbështetur prej 10 MWac që do vendoset në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier”, me nr. 9291 prot., datë 25.11.2024;
- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik ASSA” të protokolluar në OST sh.a. me nr. 760/7 prot., datë 15.04.2026 dhe në shoqërinë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., me nr. 13 prot., datë 15.04.2026, për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit.
- Shoqëria “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. është pajisur me Vendimin për VNM Paraprake me nr. AN 150920250037, datë 12.01.2026, Komisioni 05, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “PARKU FOTOVOLTAIK ASSA DHE VEPRAT NDIHMESE”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

### **NENI 9**

#### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

*Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me bërjen efektive të stafit teknik.

*Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë vendimet e organeve drejtuese të secilës prej shoqërive ortakë të saj, ku të jetë dedikuar shuma përkatëse në kuadër të financimit të 20% të vlerës totale të investimit të projektit.

#### **Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës**

2.1

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë një garanci për panelet që parashikon të përdorë, në rast se e disponon, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit.
- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE komunikimin me MIE-n, në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta (SPV) (së cilës, sipas marrëveshjes me MIE-n, i transferohen të gjitha të drejtat, ndër to dhe e drejta e operimit të impiantit), të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-s, në rast se ka pasur një të tillë; të bëjë me dije në rast se e ka

nënshkruar Marrëveshjen Përfundimtare dhe ta depozitojë atë në ERE; si dhe të përditësojë çdo informacion vijues në lidhje me zhvillimin e projektit.

- **gërma “e”**: Shoqëria duhet të japë informacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, si dhe të bëjë saktësimet përkatëse në lidhje me vendndodhjen e centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**